

AKT THEMELIMI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

Ne dy ortake Z.Jetnor Meminaj, i biri i Ylber , i datelindjes 10/02/1981, lindur Fier e me banim ne Lagjjen "Meminaj" Rruga "Hazbi Meminaj" Trevllazer Vlore , qe mbaj letemjofimin me nr. Personal I10210060P dhe Z. Kreshnik Meminaj, me nr leternjofim me nr personal I30310060U i biri i Ylber, i datelindjes 10/03/1983, lindur ne Trevllazer dhe me banim ne Lagjjen : "Meminaj" Rruga "Hazbi Meminaj" Trevllazer Vlore. Te cilet ,me cilesine e "Ortakeve Themelues ", me vullnet te lire te plote e te sinqerte, mbeshtetur ne iniciativen e lire private, Kodin Civil Shqiptar ne fuqi, ne ligjin 9901 date 14.04.2008, "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare ", ligjin nr. 9723, date 03.05.2007 " Per Qendren Kombetare te Regjistrimit si dhe ligjit te plotesuar , kerkojme qe te themelojme nje shoqeri tregtare me pergjegjesi te kufizuar, "Meminaj A.J SHPK "

KREU

I Neni

1

Krijimi

Shoqeria "Meminaj A.J SHPK ", eshte person juridik i te drejtes shqiptare, Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar (me poshte e quajtur "Shoqeria").

Neni 2

Personaliteti juridik

Shoqeria fiton personalitetin juridik pasi te jete regjistruar ne QKB, ne perputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqeria "Meminaj A.J SHPK ", eshte nje shoqeri tregtare, e themeluar nga dy ortaket , te cilet do pergjigjen per detyrimet e shoqerise tregtare dhe do mbulojne personalisht humbjet e shoqerise deri ne pjesen e pashlyer te kontributeve te nenshkruara. Kontributi i ortakeve perben kapitalin e regjistruar te shoqerise. Ortaket gezojne kuoten e tyre ne shoqeri , ne perpjestim me kontributin qe kane dhene ne kapital.


Neni 3

Selia

Shoqeria do ta kete seline e saj ne Lagjjen "Skrofotine - Novosele " Rruga Nacionale Vlore - Fier, Novosele, Vlore nr 33/26

Shoqeria mund te ndryshoje seline e saj, te hape zyra perfaqesie, dege, te krijojte filale, si brenda ashtu edhe jashte Republikes se Shqiperise, vetem me vendim te Ortakeve.

Jetnor Meminaj


ITREGJISTRIM


Neni 4
Objekti i veprimtarise

Shoqeria do te ushtroje Aktivitetet si me poshte:

Objekti I aktivitetit ekonomik te shoqerise do te jete: Tregti me pakice karburanti dhe gaz te lengshem per automjete. Import eksport dhe shitjen e tyre me pakice dhe shumice te mallrave te ndryshem industriale, ushqimore, elektroshtepiake, materiale ndertimi, lende te para per ndertim, materiale inerte, bojra, materiale hidraulike, elektrike, lende drusore, pjese kembimi, makineri, konfeksione shite-blerje dhe riparim makinash, makina me qera. Bar-sherbim ushqimor i shpejte, delivery, lavazho automjetesh dhe karikim makinash elektrike etj

Neni 5
Kohezgjatja

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj per nje periudhe kohore te pakufizuar por jo me pak se 10 vjet duke filluar nga data e regjistrimit ne Qendren Kombetare te Regjistrimit.

KREUII
KAPITALI

Neni 6
Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqerise eshte ; 100.000 leke (njeqindmije) leke , e perbere nga 2 kuota te zoteruar 50% nga ortaku Jetnor Meminaj me vlere 50.000 leke dhe 50 % nga ortaku Kreshnik Meminaj me vlere 50.000 leke Kapitali i mesiperm eshte nenshkruar dhe shlyer teresisht ne te holla nga dy ortaket e shoqerise . Kontributi i ortakeve mund te jete ne para ose ne natyre (pasuri te luajtshme/te paluajtshme apo te drejta). Ortaket pergjigjen per humbjet e shoqerise perkundrejt te tretteve deri ne vleren e kontributeve te tyre ne kapitalin themeltar te shoqerise .

Neni 7
Transferim i kapitalit

Kuotat e kapitalit te nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar e te drejtat qe rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo kalohen nepermjet:

- a) kontributit ne kapitalin e shoqerise;
- b) shitblerjes;
- c) trashegimise;
- d) dhurimit;
- e) cdo menyre tjeter te parashikuar me ligj.

Ne rastin e kalimit te kuotave me kontrate, kontrata duhet te behet me shkrim.

Personi qe kalon kuoten dhe ai qe e fiton ate pergjigjen ne menyre solidare ndaj shoqerise per detyrimet qe rrjedhin nga zoterimi i kuotes , nga casti i kalimit te kuotave, deri ne castin e rregjistrimit te kalimit te tij ne Qendren Kombetare te Rregjistrimit, sipas nenit 43 te ligjit nr. 9723, date 3.5.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit". Rregjistrimi i kalimit te kuotave ka efekt deklarativ.

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme me rruge trashegimie.

KREUII

ORGANET VENDIMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 8
Organi Vendimmarres

Jetnor Meminaj

KRESHNIK

Ortakët janë organi i vetëm vendimarrës i shoqërisë.

Ortakët janë organi vendimarrës i shoqërisë që miratojnë çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj. Çdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKR për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

Ortakët, vendosin për çështje si :

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë ;
- b) emerimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emerimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të eksperteve kontabel të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve
- e) mbikeqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë ;
- f) përfaqësimin e shoqërisë në gjykate dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- g) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblese;

Të gjitha vendimet e marra nga ortakët i vetëm regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhet regjistruar në vecanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:

- a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë ;
- b) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- c) investimet;
- d) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Vendimet e përgjystruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme . Shoqëria nuk mund t'i kundërshtojë pavlefshmerinë të tretit, që ka fituar të drejtë në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmerinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

Neni 9 Administrimi

Administrator i shoqërisë është Z. Jetnor Meminaj

Data e fillimit të administratorit është data e regjistrimit të shoqërisë në QKR.

Administratori i shoqërisë do të ushtrojë kompetencat e administrimit për një afat 5 vjeçar me të drejtë ripërsëritje.

Administratori emërohet dhe shkarkohet me vendim Asambleje të ortakëve të Shoqërisë . Administrator i Shoqërisë mund të emërohet edhe një person i tretë jashtë ortakërisë.

Neni 10 Kompetencat

Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm të veprimtarisë tregtare të shoqërisë , duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga Ortakët
- b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c) kujdeset për mbajtjen e sakte e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabel të shoqërisë ;
- d) përgatis dhe nënshkruaj bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, të paraqesin këto dokumente përpara asamblese së përgjithshme për miratim;
- e) Të krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kercenojnë mbarevajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencës së shoqërisë;
- dh) Të kryejë regjistrimet dhe të dergojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë , si parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- f) Të raportojë përpara asamblese së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të vecante për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

Administratori është i detyruar të thërrasi mbledhjen e ortakut të vetëm edhe në rastet kur :

sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktiviteti i shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim dhe kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas

Jetnor Meminaj

ITRESKLIT

regjistrimit te saj, propozon te bleje nga nje ortak pasuri , qe kane vlere me te larte se 5 % te asetëve te shoqerise, qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara.

Administratori ka te drejte te kryeje te gjitha veprimet e administrimit te zakonshem e te jashtezakonshem. Administratori perfaqeson Shoqerine perpara te gjithe personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo te huaj, autoritetëve shteterore Shqiptare apo te huaja, perfshi ketu autoritetet gjyqesore te te gjitha shkalleve. Administratori ka te gjitha kompetencat per te vepruar ne marredhenie me te tretet ne emer te shoqerise, ne te gjitha rrethanat me perjashtim te kompetencave qe ligji ia jep shprehimisht ortakeve te shoqerise. Administratori angazhon shoqerine ne marredheniet me te tretet nepermjet akteve qe jane ne perputhje me objektin e tij.

Shoqeria nuk merr persiper pasojat ndaj te treteve kur ajo provon se te tretet e dinin qe akti i administratorit e kalonte objektin e shoqerise ose kur te tretet nuk mund ta injoronin kete akt ne rrethanat e dhena, duke patur parasysh faktin se vetem shpallja e statutit nuk eshte prove e mjaftueshme.

Neni 11 Viti Financiar

Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne QKR dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni12

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund te behet ne cdo kohe :

- a) kur mbaron kohezgjatja e parashikuar ne themelimin e tij;
- b) me vendim te ortakut te vetem;
- c) me hapjen e procedurave te falimentimit;
- h) nese nuk ka kryer veprimtari tregtare per dy vjet dhe nuk eshte njoftuar pezullimi i veprimtarise ne perputhje me piken 3 te nenit 43 te ligjit nr.9723, date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit";
- d) me vendim te gjykates;

Ne kete rast Ortaket marrin vendime me shkrim ne te cilin parashikojn menyren e likuidimit te shoqerise, duke caktuar nje apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument te nxjerre prej tij emrin e likujdatorit dhe emertesën shtese " Shoqeri ne likuidim e siper" .

Neni13 Baza Ligjore

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje te plote me kete akt themelimi dhe dispozitat e legjislacionit shqiptare.

Per sa nuk parashikohet ne kete akt themelimi, do te zbatohen dispozitat e ligjit tregtare", Kodit Civil dhe cfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

Ortakët e shoqerise

Jetnor Meminaj

Kreshnik Meminaj